



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 339 Prot

Maliq, më 21.06.2022

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë, Z. Gëzim Topçiu

Lënda: Dërgohen për opinionin tuaj, rekomandimet dhe kërkesat e qytetarëve dalë nga Konsultimi Publik për draftin e parë të PBA 2023-2025, organizuar nga Këshilli i Bashkisë Maliq, në datën 15 qershor 2022.

I nderuar Z. Kryetar,

Në zbatim të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Neni 54, si dhe Vendimit të Kryesisë të Këshillit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Maliq në bashkëpunim me Ekzekutivin, organizuan konsultimin publik me komunitetin.

Konsultimi publik kishte në fokus diskutimin me komunitetin dhe marrjen e rekomandimeve në lidhje me draftin e parë të PBA 2023-2025 të bashkisë Maliq.

Po ju përcjellim për opinionin tuaj çdo rekomandim dhe kërkesë të qytetarëve, dalë në konsultimin publik të datës 15 qershor 2022 si më poshtë:

- 1-Rritja e kujdesit për moshën e tretë, krijimi i Qendrës për moshën e tretë.
- 2-Rritja e kujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuar (transport për te qendra komunitare)
- 3-Investime për ngritjen e ambejneteve sportive pranë shkollave.
- 4-Investime për rehabilitimin e shkollave në territorin e bashkisë.
- 5- Restaurim i lapidareve dhe simboleve të përkujtimit dhe respektit për të rënë.
- 6- Investime për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve Rurale.
- 7-Shtimi i këndeve të lojrave për fëmijë dhe shesheve sportive.
- 8-Sigurimi i druve të zjarrit për banorët e bashkisë Maliq.
- 9- Investime për ndërtimin e sistemve të ujit të pijshëm.
- 10-Investime në Arsimin parashkollor.(rehabilitim/ndërtim kopshtesh)
- 11-Ndërhyrje në rrugët lidhëse të parcelave.
- 12- Ndërhyrje për rehabilitimin e sistemve të ujitje-kullimit.

Lutemi për një përgjigje dhe angazhim të Ekzekutivit për reflektimin e tyre në PBA 2023-2025.

Në pritje të opinionit tuaj për cdo kërkesë apo rekomandim,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ju falenderojmë!

Me konsideratë,

Konceptoi: Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

